



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *K2/A135-8* Prot.
Nr. Dok. 201802450/8

Tiranë *05/03/2019*

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për respektimin e të drejtës ligjore të punonjësve të Policisë së Burgjeve lidhur me kompensimin e kohës së punës të bërë gjatë ditëve të pushimeve javore dhe të festave zyrtare.*

DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË BURGJEVE
Tiranë

Për dijeni : **MINISTRIT TË DREJTËSISË**
Tiranë

Ashtu sikurse jeni vënë në dijeni, në muajin dhjetor 2018, në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë një grup i punonjësve të Policisë së Burgjeve, të cilët për shkak të frikës ndaj largimit nga puna nuk identifikohen me emra. Ata shkruajnë se, deri para dy muajve para bërjes së ankesës janë paguar konform akteve normative në fuqi për punën e kryer gjatë ditëve të shtuna dhe të diela me shtesë në masën 25-50% mbi pagën normale. Ndërsa pas kësaj periudhe dhe në vazhdim me urdhër të Drejtorit të Auditit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk iu paguhet shtesa mbi pagën normale në masën 25-50% për punën e kryer gjatë ditëve të shtuna dhe të diela. Gjithashtu ata pretendojnë se, përveç mospagimit të shtesës mbi pagë, atyre po ju mbahen nga paga mujore shuma e lekëve të marra si shtesë mbi pagën për punën e kryer gjatë ditëve të shtuna dhe të diela, për periudhën që nga 01.01.2018 e në vijim.

Nisur nga ky rast dëshirojmë që t'ju sjellim në vëmendje se, në veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit, punonjësit e Policisë së Burgjeve nuk kanë qenë vetëm subjekte ndaj të cilëve janë trajtuar ankesa, por edhe subjekte që gëzojnë të drejtën ligjore t'i drejtohen atij kur iu shkelen të drejtat nga organet e administratës publike duke përfshirë edhe atë të IEVP-ve ku janë të punësuar. Ankesat e punonjësve të administratës publike, duke përfshirë edhe ata të Policisë së Burgjeve, janë vlerësuar dhe do të vlerësohen me prioritet dhe përkushtim nga ana jonë. Ne gjykojmë se, përmbushja e detyrimeve të shtetit në cilësinë e punëdhënësit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës kushtetuese të mbrojtjes shoqërore në punë, të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës dhe i të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Burgjeve të garantuara

nga ligji organik, Kodi i Punës dhe aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës të kësaj strukture do të sjellë me siguri motivimin dhe përkushtimin e tyre në kryerjen e misionit ligjor të Policisë së Burgjeve, të përcaktuar në nenin 3/1 të ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, *për garantimin e rendit dhe sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë e të paraburgosurve dhe të dënuarve.*

Problematikat që prekin punonjësit e Policisë së Burgjeve, janë trajtuar edhe më parë nga institucioni i Avokatit të Popullit. Për respektimin e të drejtave ligjore të tyre janë bërë disa rekomandime drejtuar institucioneve shtetërore. Më konkretisht: Rekomandimi i regjistruar me nr. dok. 201402346/4, datë 27.02.2015, drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve; Rekomandimi i regjistruar me nr. dok. 201402346/15, datë 04.11.2015, drejtuar Kryeministrit; Rekomandimi i regjistruar me nr. dok. 201700358/2, datë 27.03.2017, drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave; Rekomandimi me nr. dok 201800617, datë 09.10.2018, drejtuar Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Ekonomisë e Financave dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Me keqardhje duhet të pranojmë se pjesa më e madhe e këtyre rekomandimeve nuk janë zbatuar ende. Megjithatë konstatojmë se, pjesa më e madhe e tyre janë përfshirë në projektligjin e ri “Për Policinë e Burgjeve”, i cili ndodhet në fazën e shqyrtimit në Komisionet Parlamentare.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, me shkresën nr. K2/A135-2 prot., datë 18.12.2018, ju kërkuam verifikimin e kësaj ankese dhe dërgimin e përgjigjes lidhur me pretendimet e ankuesve.

Ju me shkresën nr. 12626/1 prot., datë 28.12.2018, ndërmjet të tjerave na informuat se, pretendimet e punonjësve të policisë nuk janë ashtu sikurse ata pretendojnë në ankesë. Njësia e Auditimit të Brendshëm, gjatë auditimeve të kryera në disa institucione të vartësisë, ka konstatuar se sektorë të financës, kryesisht me iniciativën e vetë dhe pa u konsultuar me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme, përfshirë edhe Auditin e Brendshëm, kanë kryer pagesa të gabuara në favor të punonjësve të policisë, duke konfunduar dispozitat ligjore në fuqi. Përveç sa më sipër, në këtë përgjigje ju shpreheni se ankesa e punonjësve të policisë nuk qëndron sepse:

1. Veçoria e punës e punonjësve të policisë është përcaktuar në kontratën e punës, sipas të cilës, puna e tyre me shërbime fillon ditën e hënë deri në ditën e dielë, deri sa plotësojnë kohën normale prej 40 orë punë në javë, ose 174 orë punë në muaj. Referuar kësaj veçorie, këta punonjës policie, nëse kanë punuar ditët e shtuna dhe të diela, e kanë bërë pushimin në ditët e zakonshme të javës. Mbi këtë llogjikë (parim) është bërë edhe planifikimi i buxhetit për vitin 2018.

2. Raportet e auditimit, ku pagesat e mësipërme janë vlerësuar si jo ligjore nga Njësia e Auditimit, janë pranuar dhe firmosur pa kundërshtime nga shefat e financës dhe titullarët e institucioneve, për pasojë mjaft prej tyre janë ndëshkuar me masa disiplinore.

3. Shtojmë se pagesa të kësaj natyre nuk janë bërë asnjëherë në sistemin e burgjeve deri në muajt e fundit të vitit 2017.

4. Shto këtij argumenti edhe faktin se në gjysmën e IEVP-ve, nuk janë bërë këto pagesa asnjëherë, megjithëse janë e njëjta kategori punonjësish dhe dispozitat që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Burgjeve, janë përkatësisht Kodi i Punës dhe ligji organik “Për Policinë e Burgjeve”, pa cituar VKM-të në zbatim të tyre.

5. VKM nr. 101, datë 15.02.2017, të cilit i referohet Sindikata Policore e Sistemit të Burgjeve, për pagesat e ditëve të shtuna dhe të diela, nuk ka asnjë lidhje me Policinë e Burgjeve, pasi është miratuar posaçërisht për Policinë e Shtetit.

Përfundimisht koha normale e punës, nuk mund të trajtohet me shtesë page prej 25-50 % siç pretendohet, pasi për ta përfutur pagën e rregullt mujore, punonjësi i policisë duhet të plotësojë 40 orë pune në javë, ose 174 orë pune në muaj, të normuara nga Kodi i Punës dhe Këshilli i Ministrave. Nëse do të veprohej ndryshe (siç kanë vepruar disa institucione deri më sot), këto të fundit marrin atributet e Qeverisë, duke rritur pagat me iniciativën e tyre.

Pagesa e pretenduar në ankesë, aplikohet vetëm kur punonjësit e institucioneve kanë kryer punë mbi kohën normale prej 174 orë në muaj, me buxhet të planifikuar deri në 200 orë punë shtesë në vit për çdo punonjës, të cilat trajtohen mbi pagën normale, me 20 % për ditët e zakoshme, 25 % shtesë për ditë pushimesh (të shtuna e të diela) të përcaktuar në VKM nr. 511, datë 24.10.2002, i ndryshuar me VKM nr. 463, datë 16.06.2011 dhe sipas Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2011 të Ministrit të Financave.

Punonjësit e policisë dhe të tjerë (me veprimtari operacionale, që kanë punuar me urdhër të eprorëve, apo të zyrtarëve të autorizuar nga ligji mbi kohën normale të punës (sidomos për rastet e gatishmërisë), janë paguar në çdo rast nga sektorët e financës brenda një periudhe dy mujore, sipas urdhrave apo listëprezencave të paraqitura nga strukturat përgjegjëse, kur institucionet kanë buxhet disponibël.

Nga përgjigjia të cilën e cituam më sipër, konstatojmë se informacioni i dërguar me këtë shkresë institucionit tonë nuk ishte i plotë dhe për këtë arsye nuk na mundësoi zgjidhjen e kësaj anese. Ndonëse për këtë çështje informacioni i dërguar i referohet kontratës së punës, nuk specifikohet se cilës kontratë, asaj kolektive të lidhur ndërmjet punëdhënësit dhe Sindikatës së Punonjësve të Policisë, apo kontratës individuale të lidhur nga secili punonjës me punëdhënësin. Gjithashtu nuk na u dërguan edhe kopje të kontratave në fjalë dhe të raporteve të auditimit, ku pagesat e mësipërme janë vlerësuar si jo ligjore nga Njësia e Auditimit, të cilat janë pranuar dhe firmosur pa kundërshtime nga shefat e financës dhe titullarët e institucioneve dhe për pasojë mjaft prej tyre janë ndëshkuar me masa disiplinore.

Për këto arsye, me shkresat nr. K2/A135-3 prot., datë 26.02.2019 dhe nr. K2/A135-2 prot., datë 08.04.2019, ju kërkua dërgimin e një informacioni shtesë dhe të dokumentave të mëposhtme:

1. Cilës kontratë i referoheni në përgjigjen e mësipërme, asaj kolektive të lidhur ndërmjet punëdhënësit dhe Sindikatës së Punonjësve të Policisë, apo kontratës individuale të lidhur nga secili punonjës me punëdhënësin.

2. Një kopje të kontratës të cilës i referoheni, asaj kolektive apo tip individuale.

3. Kopje të raporteve të auditimit, ku pagesat e mësipërme janë vlerësuar si jo ligjore nga Njësia e Auditimit, të cilat janë pranuar dhe firmosur pa kundërshtime nga shefat e financës dhe titullarët e institucioneve.

4. Kopje të akteve të procedimeve disiplinore të filluara dhe të masave disiplinore që janë dhënë ndaj personave përgjegjës.

Në vijim të ndjekjes së kësaj anese, në institucionin tonë u paraqitën dy përfaqësues të Njesisë së Auditimit të DPB të cilët sollën fotokopje të disa dokumenteve të kërkuara. Megjithatë dokumentet e sjella prej tyre nuk ishin të plota dhe për këtë arsye ju kërkua dërgimin e një informacioni dhe të dokumenteve si më poshtë:

1. Përgjigje me shkrim se cilës kontratë i referoheni në përgjigjen e mësipërme, asaj kolektive të lidhur ndërmjet punëdhënësit dhe Sindikatës së Punonjësve të Policisë, apo kontratës individuale të lidhur nga secili punonjës me punëdhënësin.

2. Fotokopje të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2011 të Ministrit të Financave.

3. Fotokopje të Udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve "Për përdorimin e fondeve të shpenzimeve korente për vitin 2017.

4. Kopje të akteve të procedimeve disiplinore të filluara dhe të masave disiplinore që janë dhënë ndaj personave përgjegjës.

Në përgjigjen e dërguar nga ju me shkresën nr. 12626/5 prot., datë 07.05.2019, na u dërgua i njëjti informacion si ai i dërguar me shkresën nr. 12626/1 prot., datë 28.12.2018, me të vetmin ndryshim në masën e përqindjes që aplikohet vetëm kur punonjësit e institucioneve kanë kryer punë mbi kohën normale prej 174 orë në muaj, me buxhet të planifikuar deri në 200 orë punë shtesë në vit për çdo punonjës, të cilët trajtohen mbi pagën normale, nga 25 % në 50 % shtesë për ditë pushimesh (të shtuna e të diela) të përcaktuar në VKM nr. 511, datë 24.10.2002, i ndryshuar me VKM nr. 463, datë 16.06.2011 dhe sipas Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2011 të Ministrit të Financave. Gjithashtu së bashku me informacionin na u dërguan edhe dokumentat e kërkuara nga ana jonë.

Nga shqyrtimi i ankesës, i përgjigjeve dhe dokumentacionit shoqërues të dërguara nga ana juaj, si dhe nga takimet e bëra me disa punonjës të Policisë së Burgjeve të rolit bazë që shërbejnë në disa nga IEVP-të në shkallë vendi¹ dhe informacioni i marrë prej tyre arritëm në përfundimin se shqetësimi i ngritur nga ankuesit është i drejtë, aktual dhe duhet t'i jepet zgjidhje.

Qëndrimi i mbajtur në trajtimin e kësaj çështjeje nga DPB e cila konfirmohet në përgjigjet e dërguara institucionit tonë, të cilat i cituam më lart, nuk është në përputhje me aktet normative në fuqi sepse:

Së pari, ankuesit nuk pretendojnë për shkeljen e të drejtës për orët shtesë mbi kohëzgjatjen ditore normale ose javore maksimale të punës, marrëdhënie e cila rregullohet nga neni 88² i Kodit të Punës, i ndryshuar; VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", i ndryshuar; si dhe Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2011 "Mbi zbatimin e VKM nr. 463, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 511, datë 24.10.2002" të Ministrit të Financave, të cilat na referoni në përgjigje.

Në rastin konkret bëhet fjalë për shkeljen e një të drejte të garantuar nga neni 87 i Kodit të Punës në lidhje me punën e kryer në ditët e pushimit javor, të cilat për shkak të veçorisë së punës të punonjësve të Policisë së Burgjeve dhe parashikimit në kontratën individuale të punës mund t'i kryejnë ato jo si gjithë punonjësit e tjerë të administratës publike. Pra, jo vetëm në ditët e shtunë dhe të dielë, por edhe gjatë ditëve të ndryshme të javës sipas grafikut të planifikuar më parë, ose në ditët e festave zyrtare, kur ato bien ditë pune. Në këtë nen parashikohet se:

"1. Puna e kryer në ditët e pushimit javor kompensohet me një shtesë page, jo më pak se 25 %, ose me pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë, jo më pak se 25% të kohëzgjatjes së kësaj pune.

2. Puna e kryer në ditët e festave zyrtare, kur ato bien ditë pune, kompensohet me një shtesë mbi pagë, jo më pak se 25 % dhe me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer në ditët e festave zyrtare"

¹ ata ngritën edhe pretendimin se nuk kompensohen me një shtesë page ose me pushim të pagueshëm për punën e kryer në ditët e tjera të javës kur ata thirren në punë ndërkohë që kanë qënë të planifikuar më parë si ditë pushimi sipas grafikut të shërbimit, si dhe për punën e kryer në ditët e festave zyrtare, kur ato bien ditë pune).

² "1. Me orë shtesë kuptohet çdo orë pune e kryer mbi kohëzgjatjen ditore normale ose javore maksimale të punës.

2. Quhet orë shtesë çdo orë pune e kryer mbi orarin normal të punëmarrësit që punon me kohë të pjesshme".

Së dyti, pavarësisht faktit që veçoria e punës e punonjësve të Policisë së Burgjeve fillon ditën e hënë deri në ditën e dielë, deri sa plotësojnë kohën normale prej 40 orë punë në javë, ose 174 orë punë në muaj; faktit që në rastet kur ata kanë punuar ditët e shtuna dhe të diela por pushimin e kanë bërë në ditët e zakonshme të javës; faktit që pagesa të kësaj natyre nuk janë bërë asnjëherë në sistemin e burgjeve deri në muajt e fundit të vitit 2017; faktit që në gjysmën e institucioneve tuaja (IEVP-ve), nuk janë bërë këto pagesa asnjëherë, megjithëse janë e njëjta kategori punonjësish, atyre nuk duhet t'u mohohet një e drejtë e garantuar nga Kodi i Punës.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese arritëm në konkluzionin se, ankuesve iu janë shkelur disa të drejta që burojnë nga marrëdhëniet e punës dhe të garantuara nga Kushtetuta, ligji nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar dhe nenet 87 dhe 123 të Kodit të Punës, i ndryshuar. Këto shkelje cenojnë interesat ekonomiko-financiare dhe të drejtën për pushim të ankuesve dhe të kolegëve të tyre të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë bërë ankesë. Disa nga të drejtat e shkeluara janë:

1. Mbajtja nga paga mujore e ankuesve të shumës së lekëve të marrë si shtesë mbi pagën për shkak të punës së kryer në ditët e pushimit javor, të cilat mund të jenë në ditët e shtunë, e dielë apo në ditët e tjera të javës kur ata thirren në punë ndërkohë që kanë qënë të planifikuar më parë si ditë pushimi sipas grafikut të shërbimit të bërë në bazë të nenit 7 të kontratës individuale të punës, në mënyrë të detyruar dhe pa u komunikuar më parë urdhrat e çdëmtimit;

2. Moskompensimi për punën e kryer në ditët e pushimit javor apo në ditët e tjera të javës kur ata thirren në punë ndërkohë që kanë qënë të planifikuar më parë si ditë pushimi sipas grafikut të shërbimit me një shtesë page, jo më pak se 25 %, ose me pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë, jo më pak se 25% të kohëzgjatjes së kësaj pune për të gjithë punonjësit e Policisë së Burgjeve;

3. Moskompensimi i punonjësve të Policisë së Burgjeve për punën e kryer në ditët e festave zyrtare, kur ato bien ditë pune, me një shtesë mbi pagë, jo më pak se 25 % dhe me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer në ditët e festave zyrtare.

Ne mendojmë se, respektimi i të drejtave të punonjësve të Policisë së Burgjeve të garantuara nga aktet normative në fuqi, përmirësimi në vijimësi i kushteve të punës, si dhe mirëtrajtimi ekonomiko-financiar i tyre, do të shërbejnë si nxitje dhe motivim për aplikimin dhe rekrutimin në këtë organ të moshave të reja.

Në këtë kuadër dhe për shkak të veçorisë së punës që kryejnë punonjësit e Policisë së Burgjeve, për rregullimin dhe unifikimin e praktikës në të gjitha IEVP-të në vend, për kompensimin me një shtesë page ose me pushim të pagueshëm për punën e kryer në ditët e pushimit javor apo në ditët e tjera të javës kur ata thirren në punë ndërkohë që kanë qënë të planifikuar më parë si ditë pushimi sipas grafikut të shërbimit, vlerësojmë se është e nevojshme përgatitja dhe miratimi i një VKM-je.

Qëndrimi i mbajtur nga DPB në trajtimin e kësaj çështjeje nuk përkon edhe me Rezolutën e OKB-së “Rregullat e Rishikuara të OKB për Standardet Minimale të Trajtimit të të Burgosurve (Rregullat Nelson Mandela)”, miratuar unanimit nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 17 Dhjetor të vitit 2015 në të cilën përcaktohen standardet minimale për menaxhimin e mirë të burgjeve. Në kapitullin e punësimit dhe pagesat, Rregullat 74 dhe 78 parashikojnë se:

“Stafi i burgut duhet të emërohet në kohë të plotë dhe duhet të ketë statusin e shërbimit civil me sigurinë e mbajtjes së vendit të punës, duke vlerësuar sjelljen e mirë, efikasitetin dhe përshtatshmërinë fizike. Për të mbështetur stafin e burgjeve në punën e

tyre, burgjet duhet të punësojnë një numër të mjaftueshëm specialistësh, duke përfshirë psikiatër, psikologë, punonjës socialë dhe mësues.

Pagat duhet të jenë adekuate për të tërhequr personel të përshtatshëm burgu dhe përfitimet e kushtet e punës duhet të jenë të favorshme në funksion të natyrës të punës”.

Ndërkohë vlerësojmë se, kontrata individuale e punës, e cila na është dërguar nga DPB, është formuluar para ndryshimeve të fundit të bëra Kodit të Punës në vitin 2015 dhe për këtë arsye është e nevojshme ndryshimi i saj duke e përmirësuar atë. Ndërsa kontrata kolektive ndërmjet punëdhësit, DPB dhe Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Burgjeve, e cila parashikohet si detyrim nga Kodi i Punës, nuk është lidhur ende.

Avokati i Popullit vlerëson se kushtet e punës dhe respektimi i të drejtave të punonjësve të Policisë së Burgjeve ndikojnë drejtpërdrejtë në sigurinë e burgjeve, por edhe në trajtimin e të burgosurve.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit... paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e menjëhershme të masave organizative nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtuesit e IEVP-ve për respektimin e të drejtës ligjore të parashikuar në nenin 87 të Kodit të Punës të punonjësve të Policisë së Burgjeve për kompensim për punën e kryer në ditët e pushimit javor të planifikuar më parë sipas grafikut të shërbimit me një shtesë page, jo më pak se 25 %, ose me pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë, jo më pak se 25% të kohëzgjatjes së kësaj pune, si dhe për punën e kryer në ditët e festave zyrtare, kur ato bien ditë pune, me një shtesë mbi pagë, jo më pak se 25 % dhe me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer në ditët e festave zyrtare.

2. Marrjen e menjëhershme të masave organizative nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtuesit e IEVP-ve për ndalimin e mbajtjes së mëtejshme nga paga mujore të shumave të lekëve të marra si kompensim nga punonjësit e Policisë së Burgjeve për punën e kryer në ditët e pushimit javor, si dhe për kthimin e shumave të mbajtura deri tani për këtë qëllim.

3. Marrjen e masave të nevojshme për të bërë planifikimin e buxheteve të ardhshme të DPB duke mbajtur në konsideratë respektimin e të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Burgjeve lidhur edhe me kompensimin e punës që do të kryejnë ditët e pushimeve javore dhe të festave zyrtare, kur ato bien ditë pushimi.

4. Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen dhe dërgimin në Këshillin e Ministrave të një VKM-je për rregullimin dhe unifikimin e praktikës në të gjitha IEVP-të në vend për kompensimin e punonjësve të Policisë së Burgjeve për punën e kryer në ditët e pushimit javor apo në ditët e tjera të javës kur ata thirren në punë ndërkohë që kanë qënë të planifikuar më parë si ditë pushimi sipas grafikut të shërbimit, si dhe për punën e kryer në ditët e festave zyrtare, kur ato bien ditë pune, me një shtesë page ose me pushim të pagueshëm jo më pak se 25%.

5. Marrjen e masave të nevojshme për të rinovuar dhe përmirësuar kontratat individuale të punës me punonjësit e Policisë së Burgjeve dhe me stafin civil të

administratës së DPB-së dhe të IEVP-ve në vend, konform me dispozitat e Kodit të Punës, të ndryshuar.


6. Marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e detyrimit ligjor të parashikuar nga dispozitat e Kodit të Punës për lidhjen e kontratës kolektive të punës ndërmjet punëdhënësit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Sindikatës së Punonjësve të Policisë së Burgjeve.

7. Analizimin e shkeljes së të drejtës ligjore të garantuar nga neni 87 i Kodit të Punës që iu është bërë punonjësve të Policisë së Burgjeve, nxjerrjen e përgjegjësive dhe marrjen e masave administrative ndaj personave përkatës.

Për masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të ktheni përgjigje brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.


Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT


Erinda Ballanca

Konceptoi: S. Nushi

Miratoi: E. Ruspi


02/03/20